



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE
SEKTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE, FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 6P3₁ prot.

Tiranë, më 24.12.2021

URDHËR

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR INSTITUTIN E MJEKËSISË
LIGJORE 2022-2024”**

Në mbështetje të VKM-së nr.680, datë 02.09.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.516, datë 01.07.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.247, datë 20.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për periudhën 2015-2020” dhe miratimin e Planit të veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve”,

URDHËROJ;

1. Miratimin e Planit të Integritetit për Institutin e Mjekësisë Ligjore
2. Ky urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Institutit të Mjekësisë Ligjore

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI

Dr. Shk. Bledar Xhemali





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

PLAN INTEGRITETI

2022-2024

Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore nr.693/1, datë 24/12/2021

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Institutin e Mjekësisë Ligjore

Ky plan u realizua nga Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit, ngritur me Urdhrin nr.693, datë 23.03.2021 të Institutit të Mjekësisë Ligjore, si vijon:

Koordinator/Kryetar: Valbona Janka (Sulejmanllari), Përgjegjëse Sektori

Anëtarë: Frida Mustafaraj, Specialiste Financë-Buxheti

Ilir Deçolli, Ekspert Mjeko-Ligjor

Ky Plan Integriteti është hartuar në përmbushje të masës A.8.3 dhe A.9.2, të objektivit strategjik A.8 dhe A.9, të Planit të Veprimit 2020-2023 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit miratuar me VKM nr.247, datë 20.03.2015, të ndryshuar. Këto objektiva parashikojnë përdorimin sistematik të mekanizmit për evidentimin e hapësirave për korrupsion dhe forcimin e integritetit të nëpunësve publikë, nëpërmjet vlerësimit të

riskut të integritetit dhe hartimit, miratimit e zbatimit të planeve të integritetit në të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë.

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL.....	4
LISTA E SHKURTESAVE	5
HYRJE	6
PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT.....	6
QASJA METODOLOGJIKE	7
OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, 2022-2024	7
RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT.....	7
MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT	10
PLANI I VEPRIMIT 2022-2024	11

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Përballja efektive me korrupsionin për Institutin e Mjekësisë Ligjore është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Instituti i Mjekësisë Ligjore ka përgjegjësinë kryesore të organizojë punën për kryerjen e ekspertimeve mjeko-ligjore, toksikologo-ligjore, biologjiko-ligjore dhe psikiatri-ligjore, të organizoj punën për kryerjen e veprimtarive kërkimore shkencore në fushën e mjekësisë ligjore, të organizojë punën për sigurimin e kualifikimit të vazhdueshëm të ekspertëve mjeko-ligjorë, toksikologo-ligjorë, biologo-ligjorë, antropologo-ligjorë, si dhe të nëpunësve të tjerë e specialistëve, veprimtaria e të cilëve lidhet me këto fusha si dhe të drejttojë veprimtarinë e shërbimeve të ekspertimit mjekoligjor në Republikën e Shqipërisë. Misioni i Institutit të Mjekësisë Ligjore është të mbështesë organet e drejtësisë, si dhe institucionet e tjera publike për zgjidhjen e çështjeve hetimore dhe gjyqësore, me karakter mjekësor e biologjik, në veprimtarinë kriminale dhe konfliktet civile, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve që përfshihen në funksionet administrative që i janë deleguar. Duke patur një rol qendror në këtë fushë, jemi të vetëdijshëm se duhet të jemi ndër të parët që të japim shembullin për t'i shërbyer interesit publik, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj. Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion.

Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës së institucionit dhe të ofrimit të shërbimit për qytetarët.

Jemi të ndërgjegjshëm se dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën, do të sigurojnë një brendësim dhe zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e publikut tek ne.

LISTA E SHKURTESAVE

MD – Ministria e Drejtësisë

MVRI – Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

IML – Instituti i Mjekësisë Ligjore

HYRJE

Planit i Integritetit për Institutin e Mjekësisë Ligjore u hartua gjatë periudhës Prill – Nëntor 2021. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2020.

Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është: i) vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e Institutit të Mjekësisë Ligjore për të kryer funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme dhe i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara si dhe ii) formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë të institucionit. Këto fusha përfshijnë: menaxhimin financiar; menaxhimin e burimeve njerëzore; kontrollin, auditimin dhe mekanizmat kundër korrupsionit; transparencën; arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve dhe informacionit; dhe hartimin e akteve të ekspertimit.

PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Institutin e Mjekësisë Ligjore konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

Me urdhërin nr. 693, datë 23.03.2021, është ngritur grupi i punës për vlerësimin e riskut dhe hartimin e Planit të Integritetit për periudhën 2022-2024.

Të gjithë anëtarët e grupit dhe punonjësit u angazhuan në procesin e hartimit të Planit të Integritetit. Nga problematikat ditore të hasura nga punonjësit gjatë kryerjes së detyrave funksionale, u grumbullua informacioni i nevojshëm. Pas analizimit të raportimeve periodike të punonjësve grupi i punës nisi procesin e identifikimit dhe analizimi i risqeve dhe faktorëve të riskut. Më pas u vijua me hartimin e masave për trajtimin e risqeve të identifikuar me qëllim përmirësimin e integritetit dhe prioritizimi i masave, duke finalizuar kështu përgatitjen e raportit për gjendjen e integritetit dhe miratimin e planit të integritetit.

QASJA METODOLOGJIKE

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në Institutin e Mjekësisë Ligjore, në përputhje me MVRI, u përdorën këto metoda:

Metodat e përdorura për vlerësimin e riskut të integritetit, janë metoda cilësore nëpërmjet takimeve me nëpunësit e institucionit, analizë e kuadrit rregullator të brendshëm dhe ajo sasiore, ku u përfshinë të gjithë punonjësit e IML-së.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, 2022-2024

Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, nëpërmjet këtij Plani Integriteti, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka vendosur tre objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2022-2024, nëpërmjet të cilëve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara. Objektivi përfundimtar i këtij plani është ndërtimi i një sistemi të brendshëm efektiv dhe forcimi i kulturës së integritetit institucional.

Objektivat strategjikë 2022-2024, të Planit të Integritetit janë:

1. Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit;
2. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore;
3. Sigurimi i nivelit më të lartë të transparencës me publikun.

Këto objektiva strategjikë bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVË TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion paraqitet në mënyrë të përmbledhur analiza dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Pas kryerjes së procesit të vlerësimit të riskut në fushat e përgjegjësisë së institucionit, rezultoi se:

- Fusha e menaxhimit financiar, risku është vlerësuar të jetë në nivel të mesëm
- Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore, risku është vlerësuar të jetë në nivel të mesëm
- Fusha e kontrollit, auditimit dhe mekanizmave kundër korrupsionit, nuk janë identifikuar risqe, IML ka hartuar edhe rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave
- Fusha e transparencës, risku është vlerësuar të jetë në nivel të ulët
- Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve dhe informacionit, risku është vlerësuar të jetë në nivel të mesëm

Nga grupi i punës duke monitoruar ecurinë normale të aktivitetin të IML-së, si dhe problematikave të shprehura nga nëpunësit, kanë identifikuar risqet dhe kanë bërë analizën e shkaktimit të tij si më poshtë:

Fusha e menaxhimit financiar

- Mos-arkëtimi i të ardhurave në kohë

Instituti i Mjekësisë Ligjore, produktin final të tij ka hartimin e akteve të ekspertimit me kërkesë të organeve kompetente, si Gjykata, Prokuroria, Avokati i Popullit etj. Pasi akti përpilohet nga eksperti përkatës, regjistrohet në sektorin përkatës dhe më pas dërgimi i aktit shoqërohet me një faturë për arkëtim, në bazë të tarifave të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë. Gjatë gjithë kohës janë hasur probleme për arkëtimin e këtyre të ardhurave kryesisht nga prokuroritë, gjë që është vënë në dukje dhe nga auditimet. Edhe pse ju jemi drejtuar me shkresë prokurorive, gjithmonë ka pasur neglizhencë në likuidimin e tarifave për aktet e ekspertimit.

- Vlerësimi i riskut të integritetit

Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të mesëm.

Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore

- Mangësi të vogla në procedurat e prokurimit

Struktura e IML-së e miratuar me urdhër të Kryeministrit, nr.70, datë 20.05.2020 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Institutit të Mjekësisë Ligjore”, është e përbërë nga 30 punonjës, nga të cilët 6 janë vende vakante. Gjithashtu në strukturën e IML-së nuk ka një pozicion jurist. Kjo ka sjellë shpeshherë pengesë në zgjidhjen e

problematikave me karakter juridik, si dhe ka ndikuar në proceset e prokurimit. Normalisht gjatë vitit, janë ngritur urdhërat përkatës përsa i përket proceseve të prokurimit, si dhe rregjistrat e prokurimit janë realizuar në kohë, por kemi hasur disa herë problematika të vogla në lidhje me zhvillimin e procedurave të prokurimit. Kjo edhe pasi prej disa kohësh nuk ka pasur trajnime të anëtarëve të komisioneve në fushën e prokurimeve.

- Vlerësimi i riskut të integritetit

Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të mesëm.

Fusha e transparencës

- Publikimi i informacionit

IML ka ndërtuar një faqe në web www.mjekesialigjore.gov.al në të cilët janë publikuar informacionet e nevojshme për të bërë transparent atë informacion që është i lejueshëm të jetë i publikuar. Gjithashtu është hartuar regjistri i kërkesë-përgjigjeve, në lidhje me kërkesat e ndryshme që janë dorëzuar pranë protokollit të IML-së, dhe kthim përgjigjeve të gjitha këtyre kërkesave të paraqitura. Gjithsesi informacioni i publikuar në ëbsite-in e IML, ka akoma nevojë për përditësim të informacionit të publikuar.

- Vlerësimi i riskut të integritetit

Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të ulët.

Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve dhe informacionit

Ka një volum pune shumë të madh për tu realizuar vetëm nga një specialist. Afërsisht numri i protokollit shkon deri në 15.000 në vit dhe ndërkohë procesi i arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumentave realizohet nga një specialist, pasi në strukturën e IML-së ka vetëm një pozicion Specialist Arkiv/Protokoll.

- Vlerësimi i riskut të integritetit

Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të mesëm.

Fusha e hartimit i akteve të ekspertimit

- Mos-realizmi në kohë i akteve të ekspertimit

Nga monitorimi i realizimit të akteve nga ekspertët nëpërmjet programit dixhital të menaxhimit të akteve që IML disponon, apo dhe nëpërmjet plotësimit të formularit tip, të

miratuar, në lidhje me ecurinë e punës së secilit ekspert, duke pasqyruar aktet në proces dhe shkaqet e mosrealizimit të tyre, u identifikua që ka vonesa herë pas here në përfundimin e akteve të ekspertimit sipas afateve ligjore.

Sa më sipër, mbingarkesa e ekspertëve me vendime, duke qenë se numri i ekspertëve në raport me vendimet që nga viti në vit kanë ardhur duke u rritur, është shumë i ulët ka bërë që ekspertët ta kenë shumë të vështirë përfundimin në kohë të akteve të ekspertimit. Gjithashtu edhe vënia në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm të kërkuar nga ana e ekspertëve për kryerjen e akteve të ekspertimit, ka patur vonesë duke sjellë mos kryerjen në kohë të aktit të ekspertimit. Një tjetër arsye është edhe mosparaqitja shtetasve në datën e caktuar të cilët janë informuar që duhet të paraqiten për ekzaminim mjeko-ligjor pranë IML-së.

- Vlerësimi i riskut të integritetit

Risku i integritetit është vlerësuar të jetë në nivel të mesëm.

MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Objektivat strategjikë të këtij plani integriteti, do të implementohen nëpërmjet planit të veprimit, i cili parashikon afatet specifike, strukturat përgjegjëse dhe të dhëna të tjera për secilin aktivitet të parashikuar.

Implementimi i planit të integritetit do të monitorohet rregullisht çdo gjashtë muaj nga Koordinator i Integritetit në institucion. Koordinator është përgjegjës për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit.

Rezultatet e monitorimit të planit të integritetit do të bëhen publike në kuadër të praktikës institucionale të transparencës.

PLANI I VEPRIMIT 2022-2024

Kuadri i brendshëm rregullator

Objektivi: Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit							
Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioritet i	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Përfshirja në Rregulloren e Brendshme e procedurave të qarta të komunikimit dhe koordinimit të brendshëm institucional	Rregullore e Brendshme e rishikuar	6M1 2022	Grupi i punës për rishikimin e rregullores dhe MD	i lartë	Koordinim i parregullt institucional, si rezultat i mungesës së rregullave të qarta të komunikimit dhe koordinimit të brendshëm duke qënë se struktura e IML ka ndryshuar në vitin 2020 ndërsa rregullorja vazhdon të jetë e vitit 2006	Rishikimi i Rregullores së Brendshme të institucionit	Burimet njerëzore të institucionit dhe MD, kosto admin. pa kosto shtesë financiare
Koordinimi me institucionet përkatëse për hartimin e një marrëveshje të përbashkët për arkëtimin e të ardhurave	Marrëveshje e përbashkët	6M2 2022	Grupi i punës për hartimin e marrëveshjes dhe Prokuroria	i mesëm	Mosarkëtimi në kohë i të ardhurave si rezultat i moslikujdimin, kryesisht nga ana e Prokurorive	Hartimi i një marrëveshje	Burimet njerëzore të institucionit dhe Prokurorisë, kosto admin. pa kosto shtesë financiare
Ndryshimi i mënyrës së kryerjes së autopsisë, përse i përket rasteve që vijnë nga rrethet, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit përkatës në mënyrë që të shmanjim vonësat	Marrëveshje e përbashkët	6M2 2022	Grupi i punës për hartimin e marrëveshjes dhe Prokuroria	I mesëm	Mos kryerja në kohë e autopsisë, për shkak të mosplotësimin të kushteve të punës apo mos pasjeses së një eksperti mjeko-ligjor në disa rrethe.	Hartimi i një marrëveshje	Burimet njerëzore të institucionit dhe Prokurorisë, kosto admin. pa kosto

							shtesë financiare
Formula e betimit, që konsiston në marrjen e detyrave të ekspertit për raste konkrete ekspertimi, të bëhet online, duke shmangur shpenzime të panevojshme dhe kursyer në kohë në mënyrë që ekspertit të ketë mundësi të përfundojë aktet e ekspertimit në kohën e duhur.	Deklaratë betimit	6M2 2022	Ekspertët	I mesëm	Mosrealizimi në kohë i akteve të ekspertimit, edhe për shkak të pjesëmarrjes në seanca gjyqësore për të bërë betimin.	Dërgimi i deklaratës së betimit në rrugë zyrtare	Burimet njerëzore të institucionit
Trajtimi financiar i ekspertëve të jashtëm, që është shumë e domosdoshme për ecurinë e punës në IML.	Rritja e pagesës	6M2 2022	Sektori i Çështjeve juridike, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	I lartë	Mosrealizimi në kohë i autopsive, akteve, për shkak të largimit të shumë ekspertëve për pagesën shumë të ulët në krahasim me mbingarkesën në punë.	Propozim i ndryshimit të trajtimit financiar të ekspertëve të jashtëm	Burimet njerëzore të institucionit dhe MD
Realizimi në kohë i akteve të ekspertimit.	Ndryshimi i strukturës	6M1 2022	Sektori i Çështjeve juridike, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	I mesëm	Mos realizimi në kohë i akteve të ekspertimit si rezultat i mbingarkesës, dhe numrit të vogël të ekspertëve. Një pengesë tjetër është vënia në dispozicion nga institucionet përkatëse të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e akteve të ekspertimit si dhe të paraqitjes në kohë të shtetasve për ekzaminim në IML.	Propozim ndryshim strukture si dhe koordinim me institucionet përkatëse	Burimet njerëzore të institucionit dhe MD
Pagesa e ekspertëve për pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, në bazë të tarifave të miratuara nga	Pagesa ekspertëve për çdo pjesëmarrje	6M2 2022	Sektori i Çështjeve juridike, Financës dhe	I mesëm	Kjo do të ndikojë në seriozitetin e pjesëmarrjes së ekspertëve në gjykata, duke shmangur edhe thirrjet	Pagesa për pjesëmarrjen e ekspertëve në seanca gjyqësore ti	Burimet njerëzore të institucionit dhe MD

Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë, siç e kanë dhe homologët tanë në Kosovë.	në seanca gjyqësore		Shërbimeve Mbështetëse		e panevojshme nga ana e gjykatave	kalorë secilit ekspert pjesëmarrës	
--	---------------------	--	------------------------	--	-----------------------------------	------------------------------------	--

2. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Objektivi: Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Ristrukturimi i IML-së për shtimin e një pozicioni "Jurist" dhe shtimi i strukturës me ekspertë mjeko-ligjor, psiakiatriko-ligjor dhe toksikologjiko-ligjor	Strukturë e re	6M1 2022	Spektori i Çështjeve juridike, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	i lartë	Vonesa në realizim e detyrave, si rezultat i numrit të pakët të ekspertëve si dhe mungesa e juristit, në raport me volumin e punës që nga viti në vit ka ardhur duke u rritur.	Ristrukturim i institucionit, shtimi i struktures me eksperte ose kontraktimi i punonjesve me kontrate te perkohshme në mënyrë të tillë që të ndihmojnë ekspertet në vjeljen e kartelave mjekësore për shtetasit objekt ekspertimi si dhe të ndihmojnë ata	Burimet njerëzore të institucionit dhe MD, kosto admin. pa kosto shtesë financiare

						në shtypjen e aktit në format word.	
Trajnimi i punonjësve për prokurimet	Punonjës të trajnuar	6M2 2022	Sektori i Çështjeve juridike, Financës dhe Shërbimeve e Mbështetëse	I lartë	Mos trajnimi i punonjësve, si dhe mungesa e juristit ka sjellë problematika të vogla gjatë procedurave të prokurimit	Trajnime për prokurim në nivele mesatar dhe në nivel të avancuar	Burimet njerëzore të institucionit dhe ASPA, pa kosto admin. pa kosto shtesë financiare

3. Transparenca me publikun

Objektivi: Sigurimi i nivelit më të lartë të transparencës me publikun

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Përditësimi i website-it, www.mjekesialigjore.gov.al	Informacioni përditësuar	Periodik	Koordinator pwr tw drejtn e informimit	I Lartë	Mundësi për ulje të besimit të publikut në punën e institucionit për shkak të mos-përditësimit periodik të faqes zyrtare me ndryshime apo informacione të reja të publikueshme	Rritja e transparencës së faqes zyrtare të IML-së, duke publikuar dokumentacionin e përditësuar të rrregjistrit të kërkesave përgjigjeve,	Burimet njerëzore të institucionit, pa kosto admin. pa kosto shtesë financiare

						rregjistrin të prokurimeve etj.	